



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:064571

Datë: 26.04.2021

Numri i dokumentit: 01730751

**PKR. nr. 100/19**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me Kryetarin e trupit gjykues Mustaf Tahiri dhe anëtarët e trupit gjykues gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani dhe Ilir Bytyqi, dhe zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.M., të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.100/19 të dt.09.07.2019 e të ndryshuar në shqyrtim gjyqësor me datë 24.03.2021, për shkak të dy veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar 2.1 të KPRK-së dhe veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, me datë 29.03.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.04.2021 përpiloi me shkrim këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari:**

**I.M.**, i lindur më ....., në fshatin .... komuna Ferizaj, nga i ati H.... dhe nëna N....., e gjinisë I....., me vendbanim në fshatin ....., komuna Ferizaj, ekonomist, .... në ATK në Ferizaj, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, prind i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal .....

**Në kuptim të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,**

## **LIROHET NGA AKUZAT**

Sepse,

I. Gjatë muajit Prill të vitit 2016, në Kaçanik, si person zyrtar – Inspektor i Administratës Tatimore të Kosovës – Rajoni Ferizaj, ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit pasurore për tjetrin – vajzën e tij J.M., në atë mënyrë që si inspektor tatimor me rastin e vizitave inspektuese të ndërmarrjes tregtare “...” me pronar B.T., ka ndikuar tek pronari që kontabilitetin e ndërmarrjes të ia mbaj vajza e tij J.M., të cilin shërbim e kryente kontabilisti M.T. nga Muaji Gusht 2014 deri me 30 prill 2016, kurse nga muaji Maj kontabilitetin e kësaj ndërmarrje ka filluar ta mbaj J.M..

**- me këtë kishte për ta kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1 lidhur me par.2 nenpar .2.1 të KPRK-së,**

II. Gjatë muajit Qershor të vitit 2018 në Ferizaj, si person zyrtar- Inspektor i administratës Tatimore të Kosovës- Rajoni Ferizaj, ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit pasurore për tjetrin- vajzën e tij J.M., në atë mënyrë që si inspektor tatimor ka kërkuar nga M.D. – kryefamiljari i pronarëve të ndërmarrjeve “...” SHPK, “...” dhe “...” , me seli në Ferizaj, që të ia marrë librat e kontabilitetit kontabilistit F.A. dhe të njejtat të ia dorëzojë atij, me qëllim që kontabilitetin e firmës ta udhëheqë vajza e tij, mirëpo pas lajmërimit të rastit në ATK dhe në Policinë e Kosovës nga kontabilisti F.A., librat e kontabilitetit përsëri pas dy muajve F.A.t.

**- Me këtë kishte për ta kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1 lidhur me par 2 nenpar 2.1 të KPRK-së,**

III. Me datë 11 maj 2016 Kaçanik, si person zyrtar- Inspektor i Administratës Tatimore të Kosovës –Rajoni Ferizaj, ka marrë pjesë në çështjen zyrtare- inspektim të ndërmarrjes tregtare “...” me seli në Kaçanik, në të cilën ka pasur interes financiar anëtar i familjes së tij, në atë mënyrë që ka ushtruar vizitë inspektuese në ndërmarrjen e përmendur së bashku me kolegun e tij M.S., në të cilën ndërmarrje ka qenë e punësuar si kontabiliste vajza e tij J.M..

**- Me këtë kishte për ta kryer veprën penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së.**

**Meqë nuk është provuar se i akuzuari I.M. ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj.**

Të dëmtuarit M.T. dhe F.A. kanë deklaruar se heqin dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Konform nenit 454 par.1 të KPP-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m i**

### **1.Historiku procedural**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën e evidentuar PP/I. nr. 180/18 të dt. 09.07.2019, ka akuzuar I.M., për shkak të dy veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar 2.1 të KPRK-së dhe veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vepruar sipas kësaj çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit Rasim Maloku në fjalën hyrëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit të saj ligjore ndërsa në fund të shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 350 par.1 të KPP-së ka bërë ndryshimin e aktakuzës ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit. Ndërsa në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së ndryshuar dhe kualifikimit juridik të veprave penale duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin I.M. ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

### **2. Mbrojtja e të akuzuarit I.M.**

I akuzuari në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nga viti 2001 punon si inspektor tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës – regjioni në Ferizaj, dhe si inspektor tatimor detyrë e tij e punës ka qenë vizitat të ndryshme në biznese – tatimpagues të kategorizuar në mënyra të ndryshme si vizita kontakti dhe vizita jashtë kontakti, mbledhjen e informatave të ndryshme e të gjitha këto në bazë të urdhrave nga eprorët dhe puna e inspektorëve në ATK- regjioni në Ferizaj ka qenë e organizuar në atë mënyrë që çdo vitë kalendarik drejtori regional ka caktuar grupin e inspektorëve në numër të caktuar nga katër – pesë inspektor se në cilin regjion do të zhvillojnë aktivitetin e tyre, por vizitat kanë mund të edhe jashtë orarit të punës por edhe në regjione tjera varësisht nga nevoja dhe urdhërat e eprorëve. Gjatë vitit 2015 -2016 i akuzuari së bashku me një inspektor tjetër ka deklaruar se ka qenë i angazhuar si inspektor në regjionin prej fshatit Gërllicë e deri në kufirin e Hanit të Elezit,

por se ka pasur raste kur edhe inspektor tjerë i kanë ndihmuar për aktivitete të ndryshme. I akuzuari ka deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë në vizitë gjatë viteve 2015 -2016 tek subjekti ekonomike “.....” në Kaçanik, duke theksuar veçanarisht se me datë 19.04.2016 dhe 11.05.2016 se nuk ka qenë në vizitë tek ky subjekt ekonomik, e as që ka komunikuar me pronarin e këtij biznesi të quajtur B.T.. Ndërsa sa i përket vizitave të datës 19.04.2016 dhe asaj të datës 11.05.2016, i njëjti ka deklaruar se ka qenë vetëm si asistues i terrenit deri te kompleksi tregtar se ku gjendet subjekti tregtar “.....”, e jo asistues i rastit të inspektorit tatimor M.S. dhe se gjatë kësaj kohe i njëjti ka deklaruar se ka pasur detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi i ekipës për të vizituar subjekte tjera.

I akuzuari ka deklaruar se vajza e tij J.M., është me profesion ekonomiste e diplomuar dhe po ashtu është e çertifikuar edhe si kontabiliste, dhe e njëjta gjithashtu është asambleiste në Kuvendin Komunal në Ferizaj si pozitë primare e saj, ndërsa merret edhe me kontabilitet si punë sekondare, ku i ka disa firma në të cilat e mban kontabilitetet, ndër to edhe tek kompania “.....” në Kaçanik, por ka deklaruar se nuk e ka ditur saktë se kur vajza e tij ka filluar të punoj në këtë kompani. I akuzuari ka deklaruar po ashtu se nuk e ka njohur më parë M.T., ndërsa F.A. e ka njohur se është kontabilist por se nuk ka pasur njohuri se i njëjti ka qenë kontabilist tek kompania “....” dhe po ashtu nuk ka njohuri që vajza e tij ka pranuar librat e kontabilitetit nga kjo kompani e gjithashtu ka deklaruar se nuk ka pasur njohuri se vajza e tij të ketë punuar si kontabiliste te kompania “....”, ndërsa ka deklaruar se ai asnjëherë nuk ka pasur ndonjë vizitë tek kjo kompani, e po ashtu nuk është takuar asnjë herë me pronarin e saj M.D..

### **3. Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor**

Pasi që i akuzuari nuk kanë pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitët e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit I.M. dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- përmes dëgjimit të dëshmitarëve M.T., F.A., B.T., M.D. dhe J.M. dhe M.S. gjatë shqyrtimit gjyqësor;

- përmes transkriptet e përgjimeve telefonike dhe raportet e vëzhgimit për të pandehurin I.M.,
- përmes raportit të ATK-së me numër 07/DSP-2018 i datës 22.02.2018 lidhur me deklarinimin e pasurisë nga I.M.,
- çertifikata e biznesit për NTP “...” dhe NTP “...”,
- raporti informues i hetuesit për vizitat përmbushëse të inspektorëve të ATK-së në ....., për datat 19.04.2016 dhe 11.05.2016,
- lista e pagave për të punsuarit në NTP “...” e lëshuar nga ATK për vitin 2016, 2017 dhe 2018,
- ankesa e F.A.,
- forma e vizitës përmbushëse nga inspektorët S.R dhe B.G. e datës 20.07.2015,
- forma për vizitë përmbushëse e datës 08.02.2016,
- forma për vizita përmbushëse e datës 22.02.2016 dhe raporti i detajuar për vizita si dhe draf raporti i kontrollës së vizitave tek biznesi NTP “...” i datës 14.02.2018,
- provat materiale të siguruara përmes ATK-së – Divizioni për përfaqësime dhe Bashkëpunim ndërinstitucional në Prishtinë me numër reference ATK/DBPN:11/20 të datës 16.11.2020 dhe atë format e vizitave përmbushëse të datave 08.02.2016, 22.02.2016, 07.03.2016, 19.04.2016, 11.05.2016 dhe 11.06.2016, kontrata e punës për J.M., së bashku me listat e pagave dhe gjendjen e trustit pensional, autorizimin për informata tatimore me numlr serik 2341374, gjendjen e trustit për J.M. si dhe shkresa tjera të cilat ATK-ja i ka bashkangjitur.

#### **4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- se i pandehuri I.M., punon si Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës- Regjioni në Ferizaj dhe atë që nga vitit 2001 e tutje,
- Se J.M. ka lidhur kontratë pune për mbajtjen e kontabilitetit në ndërrmarjën tregtare “.....” në Kaçanik,

- Se, M.T. ka punuar si kontabilist në ndërrmarjen “.....” në Kaçanik gjatë periudhës kohore 2015-2016
- Se F.A. ka punuar si kontabilist në ndërrmarjen “....” Sh.P.K gjatë periudhës kohore të vitit 2018,
- Se me datë 11 maj 2016, i akuzuari së bashku me kolegun e tij M.S. si Inspektor Tatimor kanë marr pjesë në inspektim – kontroll në ndërrmarrjen tregtare “.....” në Kaçanik.

Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarit I.M., përkatësisht vërtetimi i fakteve të përshkruara si në dispozitivet e këtij aktgjykimi, se a e ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit pasuror dhe a ka ndikuar i akuzuari I.M. tek pronari i ndërrmarjes “.....” B.T. që kontabilitetin e ndërrmarrjes të ia mbaj vajza e tij J.M. të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës. Se a e ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare i akuzuari me qëllim të përfitimit pasuror, në cilësi të inspektorit tatimor a ka kërkuar nga M.D. – pronar i ndërrmarjes “....” Shpk me seli në Ferizaj që tia merr librat e kontabilitet kontabilistit F.A. dhe të njejtat tia dorëzoj ati me qëllim që kontabilitetin tia mbaj vajza e tij J.M. të përshkruar si në dispozitivin II të aktakuzës. Si dhe me rastin e vizitës përmbushëse – kontrollës në ndërrmarjen tregtare “.....” me seli në Kaçanik, në cilësi të personit zyrtar – Inspektor i Administratës Tatimore të Kosovës – Regjioni në Ferizaj, me datë 11.05.2016, a ka qenë e punësuar aty vajza e tij J.M. në cilësi të kontabilistës të përshkruar si në dispozitivin III të aktakuzës.

Në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor i dëmtuari M.T. ka deklaruar se me profesion është ekonomist dhe se gjatë vitit 2015 – 2016 ka punuar në kompaninë “.....” në Kaçanik, me pronar B.T. dhe në atë kompani ka qenë i punësuar në bazë të kontratës dhe përveç që ka mbajtur kontabilitetin ka qenë edhe si menaxher dhe se në këtë kompani ka punuar me orar të rregullt nga ora 08:00 deri në ora 16:00, me përjashtim që ka punuar edhe jashtë këtij orari në rastet kur pronari është vonuar dhe është dashur ta pres deri të vije ai për tia dorëzuar ndrrimin. I njejtë ka deklaruar se ka ndërprerë mardhënien e punës në këtë kompani që sipas tij, pronari kishte vendosur që kontabilitetin ta kaloj tek I.M. me zyrë në Ferizaj pasi që për këtë kishin pasur marrëveshje mes të akuzuarit Ibrahim dhe pronarit të kompanisë B.T.. I dëmtuari po ashtu ka deklaruar se pronari B.T. i kishte thënë atij se po ja japim librat e kontabilitetit ti mbajë I.M. pasi që po ndihemi më të sigurt.

I dëmtuari M.T., ka deklaruar se të akuzuarin I.M. e kishte njohur vetëm gjatë vizitave që ka pasur tek kompania “.....” dhe se të njëjtin e kishte parë së paku dy herë gjatë këtyre vizitave, ku herën e parë ka deklaruar se kishte ardhur së bashku edhe me dy inspektor të tjerë dhe kjo vizitë ka qenë në orët e paraditës, ndërsa herën e dytë ka deklaruar se ka qenë vetë dhe ka qenë rreth orës 14:00 pasdite. I dëmtuari ka deklaruar se sa i përket vizitës përmbushëse nga ana e inspektorëve të ATK-së, M.S. dhe I.M. të realizuar me datë 11.05.2016 në ora 21.00 dhe atë të datës 19.04.2016 nuk i kujtohet që ka qenë prezent në atë kohë.

Gjykata me kujdes e ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit- të dëmtuarit M.T., mirëpo nga kjo dëshmi e tij e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata nuk ka mundur ti vërtetoj pretendimet faktike të paraqitura në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, sepse i njëjti deklaramet e tija janë fillimisht në kundërshtim me vetë deklaramet e tij, të dhëna edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i dëmtuari edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor për një fakt jep deklarime të ndryshme, por çka është me rëndësi është kontradiktor në tërësi me deklaramet e tija të dhëna gjatë fazës hetimeve pra është kontradiktor në sqarimin e fakteve vendimtare mbi të cilat edhe është ndërtuar ky dispozitiv i kësaj aktakuze, pasi që dispozitivi i parë i aktakuzës është i ndërtuar në tërësi mbi deklaramet e të dëmtuari M.T. të dhëna gjatë fazës së hetimeve.

Fillimit i dëmtuari M.T. në deklaratën e tij të dhënë në Policinë e Kosovës para zyrtarëve policor me datë 27.09.2018 ka deklaruar se *“po kemi pasur vizita të vazhdueshme dhe gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2015 ato vizita janë shpeshuar dhe vazhdimisht në këto vizita kanë qenë zyrtarët e ATK-së kanë qenë nga regjioni i njëjtë dhe gjithmonë ka qenë zyrtari I.M. dhe zakonisht kanë ardhur pas orës 13:00..., mirëpo në shumë raste inspektori I.M. ka ardhur edhe pas orarit të punës d.m.th. pas orës 16:00, ....e zakonisht vinin në orët e vona të mbrëmjes..., dhe kur vinte në këto raste në orët e vona ai u takonte vetëm me pronarin...dy muaj para se unë të largohem nga puna vizitat kanë qenë të shpeshta e mund të them se kanë qenë të përditshme dhe këto vizita rezultuan deri sa kontabiliteti kaloi në kompaninë e tij....qasja e tij ka qenë e vrazhdë,,gjoba të shpeshta të shqiptura....”<sup>1</sup>* e që këto janë vetëm disa nga deklaramet e tij që si dëshmitar i ka dhënë në këtë deklaratë para hetuesve, e që të gjitha këto janë në kundërshtim të plotë me deklaramet e tij dhënë në shqyrtimin gjyqësor para trupit gjykues.

Pra, ky dëshmitar ka qenë kontradiktor ku fillimisht kur para hetuesve ka deklaruar se vizitat e inspektorëve të ATK-së kanë qenë të shpeshta e duke i cilësuar ato si gati të

<sup>1</sup> Shih deklaratën e dëshmitarit M.T. dhene me datë 27.09.2018 para hetuesve policor.

“përditshme” dhe duke deklaruar se në këto vizita vazhdimisht kanë qenë zyrtarët e njejtë nga i njejtë regjion dhe gjithmonë ka qenë zyrtari I.M., ndërsa në shqyrtim gjyqësor për këtë fakt i dëmtuari ka deklaruar se të akuzuarin I.M. e ka njohur si inspektor në bazë të vizitave që ka ardhur në kompaninë “.....” dhe në këtë kompani e kam parë së paku dy herë, dhe se herën e parë në vizitë ka deklarura se ka qenë së bashku me dy inspektorë tjerë ndërsa herën e dytë ka deklaruar se i akuzuari I.M. kishte qenë vetë dhe kishte ardhur diku pas dite rreth orës 14:00 dhe kishte shkuar në zyrën e pronarit dhe është takuar me pronarin, duke deklaruar se ai nuk ka biseduar me të dhe as që ka qenë prezent në takim në zyrën e pronarit, andaj sipas kësaj që ka deklaruar i dëmtuari M.T. dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor del se të akuzuarin I.M. në kompaninë “.....” në Kaçanik, gjatë periudhës kohore prej një viti sa kishte punuar aty, e kishte parë vetëm të paktën dy herë e jo siç kishte deklaruar para hetuesve policor se i akuzuari kishte shkuar aty në vizita të përditshme me orare pa orare, gjatë orarit të punës, pas orarit të punës në orët e mbrëmjes etj. Ndërsa se i akuzuari I.M. kishte ardhur në orët e vona dhe pas orë 16:00, ashtu siç ka deklaruar në deklaratën para hetuesve policor, për këtë fakt ky dëshmitar në shqyrtim gjyqësor ka dhënë version tjetër duke deklaruar se këtë e ka mësuar nga kolegët e punës, e po ashtu nga fakti se i njejtë banon sipër kësaj kompanie dhe kam dëgjuar nga kolegët se I.M. është takuar me pronarin, por se vetë nuk e kishte parë.

Pra nga një deklaram “*bindës*” të cilin e kishte dhënë para hetuesve policor për faktin e vizitave të përditshme, ku në këtë deklaratë ka theksuar se e kishte parë në vizita të përditshme, në shqyrtim gjyqësor ky dëshmitar e zbeh dëshminë e tij duke deklaruar tani se të akuzuarin e ka parë të paktën dy herë, ndërsa për hera të tjera dhe për vizita pas orarit të punës ka dëgjuar nga kolegët e që përsosimisht ai nuk e kishte parë.

Nga gjithë kjo trupi gjykues ka vlerësuar se dëshmia e këtij dëshmitari nuk ka qenë objektive, e pa mbështetshme në asnjë prove, se ka qenë kontradiktore në tërësi, sepse fillimisht në deklaramet e tija të deponuara para hetuesve policor i njejtë ka deklaruar një krejt ndryshe nga ajo që i njejtë ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur themi krejt ndryshe gjykata e ka fjalën për faktet dhe veprimet inkriminuese të të akuzuarit, mbi të cilat është ndërtuar dispozitivi i parë i këtij aktgjykimi, mirëpo sipas vlerësimit të trupit gjykues, deklarimi i këtij dëshmitari ka qenë i mbështetur vetëm në supozime, duke mos pasur asnjë prove për ta mbështetur deklaramet e tij akuzuese, por më shumë ky dëshmitar i ndier i frustruar me humbjen e vendit të punës, pas largimit nga puna si kontabilist në kompaninë “.....”, i ka bërë të gjitha ato deklarime për ta ngarkuar tani të akuzuarin I.M. se ai është fajtori që i njejtë ka humbur vendin e punës. Kjo vërtetohet edhe nga vetë dëshmia e të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor



kur i njejt i ka deklaruar se *“unë kam deklaruar në polici që vizitat e shpeshhta nga inspektorët tatimor kanë qenë pak para se të largohem nga puna dhe unë kam menduar që këto vizita janë vetëm për të më larguar mua dhe për ta marr kontabilitetin I.M.....”* andaj, nuk është detyrë e gjykatës për të vlerësuar se çka ka menduar ky dëshmitar në atë kohë për të akuzuarin I.M. dhe për veprimet e tij, por detyrë e gjykatës është që të vërtetoj nëse vërtet në veprimet e të akuzuarit I.M. ka apo nuk ka elemente të veprës penale për të cilën i akuzuari ngarkohet, *e jo se çka ka menduar dëshmitari*, andaj me deklarime të tilla nga ana e këtij dëshmitari, të cilat kanë qenë jo objektive, kontradiktore me vetë deklaratimet e tija të më parshme, e të cilat nuk kanë pasur mbështetje në asnjë provë tjetër, trupi gjykues nuk ka mundur të vërtetoj pretendimet e prokurorit të përshkruara si në dispozitivin e parë të aktgjykimit.

Gjykata me kujdes ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit- të dëmtuarit F.A. dhënë në shqyrtimin gjyqësor i cili fillimisht ka deklaruar se i njejt i është me profesion kontabilist dhe se si kontabilist ka mbajtur librat e kontabilitetit edhe firmave *“.... Com”* dhe *“.... SHPK”* me pronar A.D. dhe F.D. dhe për mbajtjen e librave të këtyre kompanive ka deklaruar se është marrë vesh me gjyshin e pronarëve M.D. dhe pagesa sipas tij ka qenë 75 euro pagesë mujore për secilën kompani, e që shuma totale ka qenë 150 euro. I njejt i ka deklaruar se gjatë qershorit të vitit 2018, e kishte telefonuar M.D. ku i kishte kërkuar atij që ti dorëzoi librat e kontabilitetit pasi që do ti ja jap dikujt tjetër për ta mbajtur kontabilitetin, pasi që fillimisht ka deklaruar se kishte pasur disa biseda me M.D. rreth çmimit të pagës prej 150 euro, pasi që sipas tij pronarit ju kishte dukur i lartë, duke kërkuar që t`ia zbrësë pagën, mirëpo i dëmtuari ka deklaruar se nuk kishte pranuar që pagën t`ia zbrësë dhe pas kësaj dëshmitari ka deklaruar se librat e kontabilitetit i kishte dorëzuar në zyrat e kompanisë *“.... Com”*. Dëshmitari ka deklaruar se gjatë bisedës ai nuk kishte biseduar me M.... se kujt do ti ja jap ai librat e kontabilitetit sepse siç ka theksuar nuk i kishte interesuar kjo gjë. I njejt i thotë se ai ka paraqitur në ATK një ankesë ndaj inspektorit I.M., pasi që ai ka deklaruar se kishta marrë disa informacione nga disa kolegë kontabilista se këto libra të kontabilitetit M.D. ja kishte dhënë I.M. dhe për këtë deklaroi se është ftuar dhe ka dhënë deklaratë në polici.

I ballafaquar nga ana e prokurorit të shtetit me deklaratën e tij të dhënë në procedurë hetimore para hetuesve policor me datë 03.07.2018, i dëmtuari ka deklaruar se nuk është e vërtetë se ka biseduar në telefon me M.D. në fillim të muajit qershor 2018 në lidhje me librat e kontabilitetit, dhe nuk është e vërtetë që M.D. ti ketë thënë se librat e kontabilitetit ja kam dhënë I.M., e gjithashtu nuk është e vërtetë se dëshmitari ti ketë thënë po ashtu në telefon M.... se pse ia ke dhënë librat e kontabilitetit I.M., pasi që gjatë kësaj bisede ka deklaruar se nuk

është përmendur fare emri i I.M.. Dëshmitari ka deklaruar se librat e kontabilitetit i kishte marrë përsëri pas dy muajve ku e kishte thirr në telefon M.... dhe i kishte thënë që ti marr përsëri librat dhe pasi që i kishte marr dëshmtari ka deklaruar se në ato libra nuk kishte punuar asnjë kontabilist dhe ashtu siç i kishte lënë ashtu i kishte gjetur.

I dëmtuari – dëshmitari F.A. ka deklaruar se ai kishte dorëzuar me shkrim ankesë në ATK si dhe në stacionin policor në Prishtinë – Drejtoria për Krime Ekonomike pasi që siç ka deklaruar se kishte marrë informacione nga disa kolegë kontabilista se këto libra të kontabilitetit M.... do ti ja jepte I.M. dhe pas kësaj ka deklaruar se kishte dhënë deklaratë pranë Policisë së Kosovës – Drejtoria për Krime Ekonomike në Prishtinë, mirëpo në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklarimeve që i ka dhënë në shqyrtim gjyqësor para trupit gjykues, duke theksuar se ai as sot e asnjëherë më parë nuk ka pasur kurrëfar kërcënimi apo udhëzimi nga askush për deklarimin apo se si të jap dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor, duke theksuar përsëri se mbetet pranë deklaramit të tij të sotëm në shqyrtim gjyqësor se gjatë bisedës që i njejt i kishte pasur me telefon me M.D., ai asnjëherë nuk e ka përmendur emrin e I.M..

Gjykata dëshminë e të dëmtuarit – dëshmitarit F.A., e ka trajtuar me shumë në aspektin e kredibilitetit të këtij dëshmitari, duke e vlerësuar si dëshmitar jo kredibil, në raport me dëshmitë e tij të dhëna në ATK përmes ankesës me shkrim, e gjithashtu dëshminë e dhënë në stacionin Policor në Prishtinë – Drejtoria për Krime Ekonomike. Si mund të jetë kredibil një dëshmitar kur është në gjendje që dëshmitë e tij për një rast të caktuar ti ndroj sa herë që atij i konvenon, apo dëshminë e tij t'ia përshtatë situatave të caktuara, ashtu siç atij i konvenon dhe kur i konvenon. Andaj me këto deklarime të tilla ky dëshmitar e ka zbehur në tëresi kredibilitetin e tij prej dëshmitari, sa që për trupin gjykues nuk mund të mirren të besueshme aspak edhe ato njoftimet, ankesat që i njejt i ka paraqitur pranë ATK-së si dhe po ashtu nuk mund të mirret fare e besueshme deklarata e tij e dhënë në stacionin policor me datë 03.07.2018 mbi të cilat edhe është inicuar si rast ndaj të pandehurit I.M. dhe ka shërbyer si bazë për ta akuzuar të njejtin përkatësisht ndërtimin e dispozitivit të II të aktakuzës e cila është e ndërtuar në tërësi nga pretendimet e të dëmtuarit F.A., e që edhe vetë në mbrojtje e tij i njejt ka deklaruar se *“ka pasur informacione nga kolegë/shokë kontabilista se M.D. ja kishte dhënë librat e kontabilitetit I.M.”*, gjë që sipas tij edhe ai vetë nuk ka qenë i sigurt se me të vërtetë M.D. ja kishte dhënë librat e kontabilitetit të akuzuarit, por përkundër kësaj i njejt ka paraqitur ankesat e tij me shkrim në ATK dhe në policinë e Kosovës. Se librat nuk i kishte marr as i akuzuari I.M. e as ndonjë kontabilist tjetër kjo u vërtetuar edhe nga vetë deklarimi i të

dëmtuarit F.A. se librat atij i ishin kthyer atij pas dy muajve ashtu siç i kishte lënë dhe askush nuk kishte punuar në to.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.T., pronar i ndërmarjes “.....” në Kaçanik, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në kompaninë e tij, kontabilitetin e mban J.M., e cila është e punësuar aty përafërsisht nga data 20 maj e vitit 2016, e të cilën si kontabiliste ka deklaruar se ja kishte propozuar punëtorja e tij M.Ç.

Dëshmitari B.T. ka deklaruar se para se të punësohet J.M. si kontabiliste, ai kishte pasur një kontabilist tjetër të quajtur M.T. dhe arsyeja e ndërprerjes së mardhënies së punës me të ka qenë sipas tij keq menaxhimi dhe njohurit e tija me kontabilitet.

Dëshmitari B.T. ka deklaruar se gjatë kohës sa kishte punuar M.T. si kontabilist ka ndodhur që të kemi pasur kontrolla nga inspektorët tatimor, po ashtu ka ndodhur që të kemi marr edhe gjoba e dënime nga inspektorët tatimor, por edhe pasi ka filluar punën si kontabiliste Jehona ka deklaruar se i janë shqiptuar gjoba.

I njejtë ka deklaruar se gjatë kohës sa kishte punuar si kontabilist M.T. nuk e kishte parë inspektorin tatimor I.M. e as pasi që është larguar nga puna M..., inspektori I.M. nuk ka qenë në vizitë në marketin e tyre, por të njejtin më parë ka deklaruar se nuk e ka njohur, dhe ndoshta mund edhe të ketë qenë.

Dëshmitarja J.M. në dëshminë e saj ka sqaruar se si është punësuar si kontabiliste në ndërmarjen “....” në Kaçanik, se e njejtë është punësuar si kontabiliste me datë 25.05.2016 kur edhe ka nënshkruar kontratën e punës me pronarin e kësaj ndërmarje, duke shtuar se e njejtë nuk i njeh M.T. dhe F.A..

Dëshmitari M.S. në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i njejtë është inspektor në ATK- dega në Ferizaj dhe se përveç detyrave të punës që kanë në administratën tatimore, bëjnë edhe vizita përmbushëse në teren në të gjitha bizneset pa dallim veprimtarie. Ky dëshmitar ka deklaruar se nuk i kujtohet saktë se në vitin 2016 se me cilët inspektor ka qenë në ekip i caktuar të punoj, pasi që ekipet e inspektorëve dhe regjionet janë ndrruar për çdo vit, mirëpo pas shiqimit të formularit të vizitës përmbushëse me të datës 11.05.2016 të bërë në ndërmarjen “.....” në Kaçanik, dëshmitari ka deklaruar se këtë raport e ka bërë ai, ku edhe janë konstatuar të gjeturat e kësaj vizite dhe ka pohuar se prezent në këtë vizitë së bashku me të kishte qenë i pandehuri I.M., por se përgjegjësia dhe detyra kryesore ka qenë e tij dhe se i pandehuri I.M. ka qenë vetëm si shoqërues me të në cilësi të inspektorit tatimor. Tutje trupi gjykues dëshminë e këtij dëshmitari nuk e ka parë të arsyeshme ta elaboroj

pasi që trupi gjykues e ka ftuar sipas detyrës zyrtare këtë dëshmitar për ta sqaruar prezencën e tani të akuzuarit I.M. me rastin e vizitës përmbushëse të datës 11.05.2016.

Trupi gjykues, ka vlerësuar edhe provat materiale dhe atë raportet dhe transkriptet e përgjimeve telefonike si dhe raportet e vëzhgimit për të pandehurin I.M., raportin e ATK-së me numër 07/DSP-2018 i datës 22.02.2018 lidhur me deklarinimin e pasurisë të pandehurit I.M., certifikatën e biznesit për N.T.P “.....” dhe NTP “.... Com”, mirëpo nga këto prova materiale gjykata nuk ka mundur të argumetoj dhe të vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivët e aktakuzës, pasi që nga raportet e përgjimeve telefonike si dhe raportet e vëzhgimit për të pandehurin I.M. nuk ka pasur asnjë komunikim e asnjë takim lidhur me përshkrimin e veprave penale e veçanarisht kohën kur pretendohet se janë kryer këto vepra penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat materiale ankesat me shkrim të dëmtuarit F.A. drejtuar ATK- dhe Policisë së Kosovës, mirëpo këto prova gjykata i ka vlerësuar si jo të besueshme me arsyetimin e njëjtë që e ka dhënë edhe me rastin e vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit F....., duke e vlerësuar atë si dëshmitar jo kredibil, dhe jo të besueshëm, në tërë këtë proces.

Nga prova materiale që gjykata e ka siguruar në direkt përmes ATK-së - Divizioni për përfaqësime dhe Bashkëpunim ndërinstitucional në Prishtinë me numër reference ATK/DBPN:11/20 të datës 16.11.2020 dhe atë kontrata e punës në mes të N.T. “.....” nga Kaçaniku të cilën e përfaqëson B.T. si punëdhënës në një të anë dhe J.M. si punëmarrëse në anën tjetër shihet se J.M. mardhënien e punës në N.T. “.....”, e ka lidhur dhe kontratën e ka nënshkruar me datë 25.05.2016.

Gjithashtu me provën materiale që është siguruar sipas detyrës zyrtare direkt përmes ATK-së - Divizioni për përfaqësime dhe Bashkëpunim ndërinstitucional në Prishtinë me numër reference ATK/DBPN:11/20 të datës 16.11.2020 dhe atë Formulari i caktimit të punëdhënësit Kryesor i lëshuar nga ATK me numër serial .... për të punësuarën J.M., tek rubrika ku janë të shënuara informatat e të punësuarit në pikën (9) është e shënuar si “*data e fillimit të punësimit 15.05.2016*”.

Andaj gjykata këto dy provat materiale të siguruar përmes ATK-së, Divizioni për përfaqësime dhe Bashkëpunim ndërinstitucional në Prishtinë me numër reference ATK/DBPN:11/20 të datës 16.11.2020, dhe atë kontrata e punës në mes të N.T. “.....” nga Kaçaniku të cilën e përfaqëson B.T. si punëdhënës në një të anë dhe J.M. dhe Formularin e caktimit të punëdhënësit Kryesor i lëshuar nga ATK me numër serial ..... për të punësuarën

J.M., i ka vlerësuar si prova të besueshme sepse janë siguruar nga një Institucion Publik dhe pavarësisht se data e fillimit të punës sipas formularit për caktimin e punëdhënësit ku është e shënuar data 15.05.2016 nga data e shënuar në kontratën e punës si data 25.05.2016 kur J.M. ka filluar punën në N.T. “.....”, secila datë po të mirret si e saktë do ta eliminonte përgjegjësinë penale për të pandehurin I.M. i akuzuar sipas pikës III të aktakuzës për veprën penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së, pasi që sipas dispozitivit të aktakuzës i akuzuari akuzohet se me datë 11 maj 2016, në Kaçanik si person zyrtar- Inspektor i Administratës Tatimore të Kosovës –Rajoni Ferizaj, ka marrë pjesë në çështjen zyrtare- inspektim të ndërmarrjes tregtare “.....” me seli në Kaçanik, në të cilën ka pasur interes financiar anëtar i familjes së tij, në atë mënyrë që ka ushtruar vizitë inspektuese në ndërmarrjen e përmendur së bashku me kolegun e tij M.S., në të cilën ndërmarrje ka qenë e punësuar si kontabiliste vajza e tij J.M.. Andaj me veprimet e të pandehurit I.M. të përshkruara në këtë dispozitiv të aktakuzës nuk përmbushen elementet e veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së, ngase me këtë datë pra me datë **11 maj 2016** vajza e të pandehurit I.M., J.M. nuk ka qenë e punësuar fare në këtë kompani.

Andaj pas vlerësimit të të gjitha provave materiale dhe dëgjimi i dëshmitarëve të cekur më lartë, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se i akuzuari ka kryer veprat penale keqpërdorimi i pozites apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1 lidhur me par 2 nenpar 2.1 te KPRK-së të përshkruara si në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi si dhe veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së të përshkruar në dispozitivin e III të këtij aktgjykimi, e veçanarisht nuk është vërtetuar se i pandehuri si person zyrtar ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare me q

## **5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Mbrojtja e të akuzuarit I.M. në të gjitha fazat e procedurës është përqëndruar në kundërshtimin e faktve se i njejtë kishte kryer veprat penale të përshkruara si në aktakuzë, duke paraqitur mbrojtjen e tij në hollësi si në procedurën paraprake si në para trupit gjykues, andaj gjykata e ka vlerësuar se mbrojtja e tij për faktet vendimtare të kësaj çështje penale, përkatësisht se i njejtë nuk ka pasur kurrfarë kontakti asnjëherë me B.T.n e as me M.D.nnë lidhje me punësimin e vajzës së tij si kontabiliste dhe se nuk ka pasur kurrfarë ndikimi tek pronarët e kompanive “.....” dhe “.... Shpk”, “.... Com” dhe “....” që kontabilitetin e këtyre ndërmarrjeve ta marrë vajza e tij, një mbrojtje e tillë është besueshme meqë e njejtë mbështet në tërësi me deklarimin e dëshmitarëve të “.....” dhe “.... Shpk”, “.... ” por edhe në provat tjera materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

## **6. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit<sup>2</sup>.**

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës së ndryshuar me datë 24.03.2021 dhe kualifikimit juridik të veprave penale duke propozuar që të akuzuarin I.M. ta shpall fajtor dhe të i shqiptohet dënim sipas ligjit. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka përshkruar provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat janë elaboruar hollësisht si më lartë, e për të cilat gjykata ka dhënë vlerësime për secilën veç e veç, e nga ato shpjegime të dhëna në mënyrë të çartë për të gjitha këto prova materiale dhe për gjitha dëshmitë e dëshmitarëve gjykata nga të gjitha këto nuk ka mundur ti vërtetoj pretendimet e prokurorit të shtetit të theksuara në fjalën përfundimtare, për faktin se këto pretendime të prokurorit të shtetit janë në kundërshtim me të gjitha ato që u theksuan më lartë pasi që nga këto prova materiale në thelb nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari është kryes i këtyre vepra penale sipas kësaj aktakuze. Sa i përket provave materiale asnjëra nga ato që ëshët propozuar nga ana e prokurorit të shtetit nuk ka arritur të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer këto vepra penale.

Prokurori i shtetit ka theksuar se gjendja faktike është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit M.T. dhe F.A., mirëpo gjykata dëshminë e këtyre dy dëshmitarëve e ka vlerësuar si dëshmi jo objektive, pasi që të dy këta dëshmitarë kanë qenë kontradiktor, jo koherent me deklaratimet e tyre të mëparshme, sidomos me deklaratimet e tyre në fazën hetimore mbi dëshmitë e të cilëve është ngritur kjo aktakuzë, dhe me vetë faktin se të njëjtit edhe dëshmitari M.T. edhe dëshmitari F.A., kanë pasur ndryshime substanciale të deklaratimeve të tyre në raport me faktet vendimtare, ku fillimisht në deklaratat e tyre në fazën hetimore kanë inkriminuar në masë të madhe tani të akuzuarin, ndërsa në shqyrtim gjyqësor kanë pasur deklaratime krejt ndryshe, shtrohet pyetja? Si mund gjykata ta shpallë fajtor një të akuzuar mbi dëshminë e një dëshmitari jo kredibil, e aq më pak kur dëshmitë e tyre janë në kundërshtim me vetveten, e gjithashtu këto dëshmi nuk gjejnë asnjë mbështetje në provat materiale dhe kanë ngelur në nivelin e supozimeve, duke menduar që fajtori për largimin e tyre nga punë është I.M..

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare ka përmendur edhe raportin e Administratës Tatimore të Kosovës – Divizioni për përfaqësime ku nga ky raport vërtetohet se I.M. ka qenë në vizita në cilësi të astituesit në ndërmarrjen “.....” në Kaçanik në cilësi të astituesit me datat 19.04.2016 dhe 11.05.2016, kjo nuk është kontestuese që i pandehurit I.M. ka qenë në këto dy vizita, në bazë të asaj që ka deklaruar dëshmitari M.S., por edhe dëshmitari B.T. kanë qenë

<sup>2</sup> Shih fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit të paraqitur me shkrim.

vizita të rregullta përmbushese, dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar pretendimi i prokurorit të shtetit se këto dy vizita nga ana e të akuzuarit janë bërë për qëllim për tu takuar me pronarin B.T. me qëllim të ndikimit tak ai që vajza e tij të merr mbajtjen e librave kontabilitetit pasi që këto vizita kanë qenë vizita zyrtare. Se këto vizita kanë qenë zyrtare dhe se për këto dy vizita është përpiluar procesverbal vërtetohet edhe nga provat materiale dhe atë nga format standarde për vizita përmbushëse e ATK-së, ku janë konstatuar të gjeturuar dhe rekomandimet dhe është nënshkruar nga të gjitha palët pjesëmarrëse në atë vizitë, andaj nga këto vizita nuk mund të vërtetohen pretendimet e prokurorit të shtetit se qëllimi i të pandehurit ka qenë ndikimi tek pronari i kësaj ndërrmarje që vajza e tij ti punësohet si kontabiliste.

Gjithashtu prokurori i shtetit në fjalën përfundimare ka përmendur edhe vizitat përmbushëse 08.02.2016, 22.02.2016 dhe 23.02.2016 të cilat sipas dëshmitarit M.T. kanë qenë preteks për largimin e tij nga puna dhe librat e kontabilitetit tia dorëzoj vajzës së I.M., ky pretendim – preteks i dëshmitarit M.T., mbi të cilin pretendim edhe prokurori i shtetit e mbështet fjalën përfundimtare, nuk është aspak i qëndrueshëm pasi që nga vetë këto raporte del se në asnjërin nga këto tre vizita i akuzuari nuk ka qenë pjesë e ekipës së inspektorëve që kanë kryer këto vizita. Në vizitën e datës 08.02.2016 vërtetohet se kanë marrë pjesë inspektorët e ATK-së të regjionit të Ferizajit S.R dhe H.K., në vizitën e datë 22.06.2016 kanë marrë pjesë inspektorët tatimor të ATK-së V.N. nga regjioni Prishtina 3, ndërsa në vizitën e datës 23.06.2016 kanë marrë pjesë inspektorët tatimore të ATK-së nga regjionit të Ferizajt S.R. dhe F.H., andaj nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorit të shtetit se këto vizita kanë qenë si preteks për largimin e dëshmitarit M.T. nga puna, por siç ka cekur edhe vetë prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare “*të cilat sipas dëshmitarit kanë qenë preteks për largimin e tij nga puna...*”, e të cilat me të vërtet janë pretendime të supozuara të dëshmitarit M.T., e jo fakte që janë provuar a po kanë ndonjë mbështetje në provat materiale.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga raporti i ATK-së janë siguruar edhe listat e pagave të ndërrmarjes “.....” për vitin 2014-2015 ku vërtetohet se dëshmitari M.T. ka qenë në listën e pagave prej muajit gusht 2014, për vitin 2015 si dhe për katër muajt e par të vitit 2016, ku edhe pa asnjë arsye i ndërpritet marrëdhënia e punës në këtë ndërrmarje ku kishte punuar si kontabilist dhe në të njëjtin vend të punës punësohet J.M. vajza e të akuzuarit.

Për gjykatën kjo nuk është kontestuese se vajza e të pandehurit I.M., J.M. është punësuar si kontabiliste në ndërrmarjes “.....”, mirëpo e njëjta është punësuar si kontabiliste me

datë 15.05.2016 pra katër ditë pas datës 11.05.2016, e që është koha kur i akuzuari ka qenë në vizitë zyrtare në këtë kompani, dhe në këtë kohë pra nuk ka qenë e punësuar vajza e tij si kontabiliste në këtë kompani dhe veprimet e tija me rastin e vizitës në këtë kompani nuk kanë konsumuar elementet e veprës penale të konfliktit të interesit nga neni 424 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, të gjitha këto që u cekën më lartë i ka vlerësuar duke i ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "*in peius*" ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "*in favorem*" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

#### **7. Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale**

Të dëmtuarit M.T. dhe F.A. në shqyrtim gjyqësor kanë deklaruar se heqin dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Konform nenit 454 par.1 të KPP-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e kësaj gjykate.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,  
PKR.nr. 100/19, më datë 26.04.2021.**

**Zyrtarja ligjore,  
Gentiana Hoxha**

**Kryetari i trupit gjykues,  
Mustaf Tahiri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.



Numri i lëndës: 2018:064571  
Datë: 26.04.2021  
Numri i dokumentit: 01730751